

KOSOVARJA

**DASMA
E SHINDËRRUAR**
në festë shoqërore





ADRESA E
SË ARDHMES.
CIMA GRAND COMPLEX
PRISHTINA E RE

FROM VISION TO
Grand reality.

+383 48 581 888 www.cimaks.com

Në zemër të Dukagjinit, aty ku historia dhe krenaria familjare ndërthuren natyrshëm me jetën e përditshme, u zhvillua një nga ngjarjet më të bukura familjare të ditëve të fundit. Luan Haradinaj i dha fund beqarisë në një ceremoni të veçantë, duke kurorëzuar dashurinë e tij me Anilën në një atmosferë që reflektonte si traditën, ashtu edhe elegancën bashkëkohore.

*Dasma e shndërruar
në festë shoqërore*



Ceremonia u mbajt në Glllogjan, në kullën e familjes Haradinaj, një vend që mbart simbolikë të thellë historike dhe emocionale. Në këtë ambient autentik, dasma mori një dimension më të madh se një festë personale: ishte një rikujtim i rrënjëve, i trashëgimisë dhe i lidhjes së fortë familjare.

Fotografitë dhe videot e publikuara nga të pranishmit, shfaqin një çift të buzëqeshur, të lumtur dhe plot dritë. Luani dhe Anila duken më të afërt se kurrë, duke reflektuar një dashuri të qetë, por të thellë, teksa festojnë një nga momentet më të rëndësishme të jetës së tyre.

Atmosfera në Glllogjan ishte e mrekulueshme dhe familjare, e mbushur me urime të singerta dhe emocione të forta. Megjithatë, festa nuk përfundoi aty. Banketi madhështor u organizua në Prishtinë, ku morën pjesë figura të njohura nga politika, arti dhe jeta publike. Ky dimension i dytë i dasmës solli një shkëlqim të veçantë, duke e kthyer ngjarjen në një festë të gjerë shoqërore.

Një nga momentet më të spikatura të mbrëmjes ishte prania e Rifat Jasharit, vallëzimi i të cilit i dha një energji të veçantë atmosferës festive dhe u prit me entuziazëm nga të ftuarit.

Ndër imazhet më prekëse të publikuara, veçohen ato ku Luani shfaqet pranë nënës së tij, Suzana Haradinaj. Në një fotografi, ata shihen duke kërcyer së bashku, një moment që tejkalon festën dhe prek dimensionin emocional të lidhjes nënë-bir. Në një tjetër, Suzana duartroket çiftin me një buzëqeshje krenarie dhe dashurie, duke e bërë atë çast edhe më domethënës.

Kjo dasmë nuk ishte vetëm një bashkim i dy njerëzve, por një reflektim i vlerave familjare, i respektit për traditën dhe i gëzimit të gjithëve. Nga kulla në Glllogjan deri te banketi në kryeqytet, çdo detaj tregoi një histori, atë të dashurisë, kujtesës dhe fillimeve të reja.

Foto: Norik Uka





Në pjesën veriore të sarajeve të familjes së njohur të Vlorajve, vetëm pak metra larg saj, aty ku sot ndodhet Hotel “Sazani”, ka qenë një godinë dykatëshe, e cila nga vlonjatët e vjetër njihej me emrin “Shtëpia e kosovarëve”.

Godina që ka ekzistuar në Vlorë deri në vitin 1925, ka qenë dëshmi e ngjarjes më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë, asaj të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. Godina dykatëshe lidhet me emrin e personazhit të njohur të lëvizjes patriotike shqiptare nga Kosova, Isa Boletinit. Sipas historianëve, Isa Boletini mbërriti në Vlorë një ditë pas aktit të shpalljes së pavarësisë, në krye të disa dhjetëra luftëtarëve, të gatshëm të mbronin me jetën e tyre qeverinë dhe tërësinë territoriale të shtetit të parë shqiptar. Ai u vendos në atë godinë. Ndërkohë, në ato ditë të vështira, trupat e komanduara nga Isa Boletini u vendosën në dy pozicione, në krye të lagjeve “Muradie” e “Topana”, të cilat vlerësoheshin nga strategët ushtarakë të kohës mjaft të favorshme për realizimin e detyrës së mbrojtjes së aktivitetit të qeverisë së Pavarësisë.

25 KOSOVARË E MBROJTËN QEVERINË E ISMAIL QEMALIT DERI NË VITIN 1925

Kufijtë e këtyre dy lagjeve, ndër më të vjetrat në qytetin e Vlorës, u bënë edhe barriera e pakapërcyeshme për çdo tentativë të mundshme të kundërshtarëve të aktit më të madh të historisë së Shqipërisë, pavarësisë së saj. Me ditë e javë të tëra trupat e komanduara nga Isa Boletini qëndruan në rojë të aktivitetit të Qeverisë së drejtuar nga Ismail Qemali. Por, historia e patriotit të njohur nga Kosova nuk mbaron këtu. Ajo do të vazhdojë edhe në vitet pasardhëse. Pas largimit të tij nga Vlora, Isa Boletini la në shërbim të qeverisë së Ismail Qemalit 25 burra nga Kosova. Luftëtarët nga Kosova qëndruan në Vlorë deri në vitin 1925. Ata cilësoheshin si një trupë e zgjedhur dhe mjaft besnike ndaj Ismail Qemalit, duke zbatuar detyrat e lëna nga komandanti i tyre. 25 kosovarët

Iu rrafshua shtëpia Isa Boletinit!



i shërbyen qeverisë së përkohshme edhe pas vendosjes së rendit në Vlorë, për vite me radhë. Shtëpia e tyre ishte godina dykatëshe, në afërsi të sarajeve të familjes Vlora, e cila u ishte dhënë në shenjë mirënjohjeje. 25 kosovarët qëndruan aty deri në vitin 1925. Ishte pikërisht ky momenti kur nis të marrë jetë një projekt i bashkisë së atëhershme të qytetit për të ndërtuar një lulishte të madhe në zemër të Vlorës, atje ku ajo është edhe sot, në “Sheshin e Flamurit”. Bashkë me sarajet e Vlorajve u rrafshua edhe godina dykatëshe. Të dy këto objekte, dëshmitare të periudhës së Pavarësisë, u prishën për t’ia lënë vendin një mjedisi të gjelbëruar që edhe sot përbën një nga krenaritë e Vlorës. Godina dykatëshe ka mbetur edhe sot në kujtesën e të moshuarve, me emrin “Shtëpia e kosovarëve”. Disa prej tyre u larguan drejt vendlindjes


në vitin 1925. Por, disa syresh qëndruan në Vlorë, duke u bërë pjesë e komunitetit vlonjat. Ata ndërtuan këtu jetën, krijuan familje, lanë pas trashëgimtarë.

MONUMENT HISTORIK PA ASNJË FOTOGRAFI!

Në këtë sfond të ngarkuar me ngjarje, godina dykatëshe e emërtuar “Shtëpia e kosovarëve”, që qëndronte aty ku sot është Lulishtja e “Sheshit të Flamurit”, është simbolika e një ideali të përbashkët të të gjithë shqiptarëve, nga të gjitha trevat e Shqipërisë. Prej saj nuk ka mbetur asnjë foto, por kujtimi i saj është i gjallë. Në përkujtim të kësaj ngjarjeje dhe si mirënjohje ndaj kontributit të shqiptarëve të Kosovës në çështjen e pavarësisë, bashkia i ka vendosur emrin e Boletinit një rrugë të qytetit.

Populli

Qeveria



Pronar dhe botues:
Gani DILLI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILLI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu Bajoku

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

KUSH PO E HA KOSOVËN?

*“Kosova asht livadh i madh! E hanë edhe kuajt qorr!”,
thoshte im gjysh.*

Thoshte jo rrallë im gjysh, e që po më kujtohen si sot fjalët e tij: “Kosova asht livadh i madh, babo! E hanë edhe kuajt qorr!”.

Im gjysh, Zeneli, kishte pas qenë asker i Perandorisë Osmane dhe luftërat e kishin qitur që ai të jetojë në Stamboll hiç më pak se 13 vjet! Histori e gjatë e tij, por me këtë rast më kujtohet një detaj që e tregonte shpeshherë, kur bëheshin trazira në Kosovë...

Tregonte se si baba-mbret i Turkisë, sa herë qohej, me sabah, shkante te kali-at i tij dhe lutej: “Ma bafsh baglën në Kosovë!”. Demek, Kosova ishte një pasuri që ka ditur me e falë veç Zoti në

këtë dynja...

Andaj, edhe perandoritë, krajlitë e mbretëritë turli-turli e lakmonin të gjithë ta pushtonin, ta fitonin, ta kenë të veten...

Tregim ky që për momentin aktual flet shumë...

Flet dhe tregon shumë pse-he për problemin që s’largohej nga Kosova tash e shekuj me radhë...

Andaj, po i përsëris fjalët e tim gjyshi: “Kosova - livadh i madh!”.

Kush po e kullotë?

Kush po e kositë?

Kush po e hanë?

Gani Dili

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:


Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Xhorxh Vashingtoni me prejardhje shqiptare. Amaneti i tij për shqiptarët: “Amerika u ka borxh shqiptarëve”. Thuhet që Presidenti Vashington ta ketë lënë një letër-amanet për mbrojtjen e shqiptarëve nga Amerika në çdo kohë dhe në çdo mënyrë...

Hulumtimi i Institutit të Gjenetikës nga “Schafhausen” i Zvicrës tregon se Xhorxh Vashingtoni ishte 50 për qind shqiptar, që nënkupton se njëri prind i tij ishte 100 për qind shqiptar. Xhorxh Vashingtoni ka qenë lideri kryesor politik e ushtarak i SHBA-së në vitet 1775-1799, i cili e udhëhoqi vendin drejt fitores në luftën çlirimtare kundër Britanisë së Madhe, ishte në krye të vendit në kohën e shkrimit të Kushtetutës dhe zhvilloi praktikat presidenciale të qeverisjes, që edhe sot janë gurë-themelet e punës në Shtëpinë e Bardhë. Në SHBA ai konsiderohet si “Babai i Kombit”.

E ëma e Xhorxh Vashingtonit ishte shqiptare, sipas lingvistit Albert Myko, nga Instituti i Linguistikës pranë Universitetit “Berkley” të Kalifornisë, SHBA. Por, ekzistojnë edhe dëshmi të tjera që tregojnë se e ëma e Xhorxh Vashingtonit ishte shqiptare. Xhorxh Vashingtoni ishte i biri i Augustin Vashingtonit dhe Mari Ball Vashingtonit. Mari, në fakt, ishte Marije Bala, prindërit e së cilës ishin nga rrethi i Pejës, në Kosovën e sotme. Marija ka lindur në Lively të Virxhinisë, në SHBA, në vitin 1708, por prindërit e saj kanë ardhur aty më 1706, pas një udhëtimit të gjatë me anije që nisi nga Ragusa (Dubrovniku i sotëm) dhe i çoi ata përmes Britanisë deri në Amerikë. Historia e udhëtimit të gjyshërve të Vashingtonit nga Kosova në Amerikë është e përshkruar në librin biografik “Mary Ball Washington”, të autores Virginia Carmichael, i botuar më 1850. “Aty, madje, thuhet se Balajt kishin ardhur nga një fshat i quajtur Sinic, që mund të jetë ngatërrim i emrit të fshatit Isniq, në komunën e Deçanit”, thotë Myko, i cili tregon se kjo histori deri vonë është mbajtur e fshehur në sirtarët e Shtëpisë së Bardhë dhe se përmendja e prejardhjes shqiptare të Vashingtonit është hequr nga lista e temave të ndaluara nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë i SHBA-së vetëm para pak kohe. Në lidhje me këtë, zyrtarë nga Shtëpia e Bardhë kanë pranuar të thonë se “nuk ishte e rastit që zëvendëspresidenti Bajden e ka përmendur presidentin Vashington në relacion me kryeministrin e Kosovës”.



Amerika ua kthen borxhin shqiptarëve!

AMANETI I VASHINGTONIT

Sidoqoftë, zbulimi i fundit, mbase hedh dritë edhe në disa aspekte të tjera të përfshirjes amerikane në Kosovë dhe të mbështetjes për shqiptarë, në përgjithësi. Autori i mirënjohur amerikan, Karl Vud, që ka shkruar dhjetëra libra dokumentarë për presidentët amerikanë dhe historitë nga Shtëpia e Bardhë, thotë se gjatë hulumtimit të arkivave për librin e tij rreth presidencës Klinton, botuar më 2004, me titull “Shtëpia Klinton”, ka gjetur një letër-proklamatë të vet Xhorxh Vashingtonit, në lidhje me shqiptarët. “Më kujtohet, kur e mora letrën për t’ia treguar Bill Klintonit, në njërën nga intervistat e shumta për libër dhe i thashë: “Shih Bill ç’kam zbuluar nga arkivat e Vashingtonit!”. Ai, me të parë letrën, më tha: “E kam parë Karl, e kam parë. Mos ta kisha parë, një Zot e di nëse do të kishim intervenuar në Kosovë”, tregon Vud, i njohur si gazetar, reporter e autor që ka fituar deri tani katër çmime “Pulitzer”. Ai thotë të mos e ketë përfshirë letrën e Vashingtonit në librin për Klintonin, sepse tani përgatit librin e posaçëm për Vashingtonin dhe prejardhjen e tij shqiptare. Vud thotë se mendohet nëse do ta titullojë librin “Xhorxh Vashingtoni-shqiptari i parë në Shtëpinë e Bardhë” apo “Shqiptari nga Kosova që krijoi shtetin e Amerikës”.

NIKSONI IA DHA KOSOVËS KUSHTETUTËN E VITIT '74

“Në një farë mënyre, angazhimi i SHBA-së në favor të shqiptarëve është një borxh që Amerika tani ia kthen popullit që lindi themeluesin e vet Amerikës. Nga hulumtimet shihet qartë se edhe presidenti Vilson

e kishte lexuar këtë letër në kohën kur duhej vendosur për krijimin e shtetit të pavarur të Shqipërisë”, thotë Vud, dhe shton: “Njëlloj, presidenti Nikson ishte njeriu kyç që ka kontribuar në arritjen e autonomisë së Kosovës, me Kushtetutën e vitit 1974”. Tutje ai shton: “Nikson dhe Tito kishin një takim, në vitin 1970, në të cilin presidenti amerikan zotoi një ndihmë të pakthyeshme prej 5 miliardë dollarësh për Jugosllavinë, nga 500 milionë në vit deri më 1980, në shkëmbim për dhënien e autonomisë së plotë për Kosovën. Tito u dakordua dhe gjithçka nisi aty: krijimi i Universitetit të Prishtinës, amendamentet kushtetuese të vitit 1971, Kushtetuta e vitit 1974, e kështu me radhë”, tregon Vud. “Madje, një vazhdim i ndihmës ka qenë i paraparë në një diskutim mes Titos dhe presidentit tjetër amerikan, Xhimi Karter, për vitet 1980-1990, për marrjen e të cilës Tito ishte i pajtimit që Kosovës t’i jepte statusin e republikës. Por, Tito vdiq, serbët lëvizën kundër autonomisë, amerikanët ndërprejnë ndihmën...”, tregon Vud. Sidoqoftë, Vud beson se të gjithë presidentët amerikanë e kanë lexuar letrën e Vashingtonit dhe kanë qenë të obliguar nga ajo t’u ndihmojnë shqiptarëve, në mënyra të ndryshme dhe në faza të ndryshme të historisë. Autori amerikan nuk dëshiron ta zbulojë përmbajtjen e letrës, duke thënë se duhet të prisni daljen e librit, por thotë se ato që i ka lënë të shkruara Vashingtoni do të qartësojnë shumëçka në lidhje me raportet e SHBA-së me shqiptarët. Në lidhje me zbulimin epokal të prejardhjes shqiptare të Xhorxh Vashingtonit, si dhe pohimeve të tjera të padëgjua deri më tani, Ambasada Amerikane në Prishtinë nuk ka dhënë asnjë koment.



FESTINA

Watches since 1902

Gerard Butler & Martina Klein



IAS
SINCE 1971

Është për t'u brengosur se kafenetë në qytetin e Ferizajt, ku jetoj e jam i lindur edhe unë, janë të stërmbushura me nxënës, kryesisht me nxënës të shkollave të mesme! Madje, edhe më shqetësues është fakti se këto lokale nga ta vizitohen edhe gjatë pushimit të gjatë ndërmjet orëve dhe kjo është tmerruese, sepse ata jo vetëm që shpenzojnë nga buxheti edhe ashtu i varfër i familjarëve, edhe vonohen në orët e mësimt. Por, edhe më e keqja është se ka edhe të tillë që nuk e prishin rahatit fare në kafiteri – nuk shkojnë fare në orët e fundit të mësimt! Andaj, edhe është shqetësues fakti se çka presim në të ardhmen nga kjo gjeneratë të rinjsh, e që pjesën më të madhe të kohës e kalon nëpër kafene gjatë tërë ditës...

SHKOLLARËT EDHE NË KAZINO...

Kjo, me të vërtetë, është për t'u brengosur për rininë ferizajase, sepse ata, meqë janë të rinj, shumica prej tyre edhe adoleshentë, mund të manipulohen shumë lehtë dhe të merren me dukuri negative që vijnë pikërisht nga kafenetë, e që pasojat për ta në të ardhmen do të jenë shumë të mëdha dhe të pariparueshme. Mendoj se gjërat e tilla ndodhin shkaku se nuk këshillohen mirë, janë të rinj energjikë dhe ashtu e shohin botën për momentin, por pa i menduar pasojat në të ardhmen. Dhe, një shqetësim tjetër dhe shumë i madh është edhe ai i prindërve, të cilët me sakrificë dhe mund të madh i kanë rritur fëmijët e tyre në këto ditë skamjeje në Ferizaj dhe kudo në Kosovë, ani pse 26 vjet pas luftime. Ata, shumica prej tyre, nga hallet dhe brengat e jetës, pak, për të mos thënë fare, merren me edukimin dhe përcjelljen e fëmijëve të tyre, ku shkojnë e ku rrinë ata: në shkollë për të mësuar apo në kafene, në bastore sportive, apo edhe më keq - në kazino! Dhe, pa dyshim, është e tmerrshme të vizitohen këto vende nga nxënësit, ku nga këto vende dihet që asgjë e mirë nuk mund të dalë pos që sjellin probleme në shoqëri dhe e çrrëgullojnë rehatinë familjare dhe i

shqetësojnë prindërit, të cilët më së paku e meritojnë.

DHUNË SI NË FILMA KAUBOJ!

Prandaj, familja, shkolla dhe shoqëria jonë në përgjithësi, duhet të merren më intensivisht me edukimin e fëmijëve tanë, në mënyrë që ata të mos ua lëmë stihisë. Të intervenohet urgjentisht në shkollë, të bëhen edhe konsulta me psikologë e pedagogë, nëse duam ta parandalojmë devijimin nxënësve nga dukuritë negative që janë të shumta tash për tash në shoqërinë tonë. Dhe, njëkohësisht, të merren masa në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, e që edhe kjo dukuri ka marrë përmasa shqetësuese, rrahën e theren nxënësit si me qenë në ndonjë arenë luftime e jo në institucione edukativo-arsimore! Të shtohet një kujdes më i madh i Ministrisë së Arsimit, konkretisht i drejtorisë së arsimit, që të angazhohen më shumë në këtë drejtim drejtorët dhe mësimdhënësit, në mënyrë që të ngrihet niveli i dijes, ashtu që të bindën shkollat tanë të mos i vizitojnë vendet e lartpërmendura, por t'i përkushtohen më shumë mësimt dhe sjelljeve të mira njerëzore...

Naim Sadiki

Shkollarët në kafene si në odë të babës!



Përjetim i hidhur

Jam një grua e martuar dhe e kam një djalë të vogël. Ndhem shumë keq për mendimet që më kalojnë nëpër kokë, por nuk di se si ta frenoj veten. Jeta ime familjare po turbullohet çdo ditë e më shumë shkakut i një ndjenje që po lind brenda meje. Nuk dua t'ia pranoj as vetes, por qenka e vështirë që të mbysësh zërin e ndërjegjes...

Për herë të parë e dashuruar, por jo me burrin

Jam martuar me mesit. Ma prezantoi teza e burrit, të cilën e kishim fqinj. Më pëlqeu im shoq që në takimin e parë. Unë isha vajzë e vetme dhe prindërit më kishin qëndruar para e mbrapa gjatë gjithë kohës. Nuk kam pasur kurrë të dashur apo ndonjë histori dashurie përpara se ta njihja tim shoq. Kam qenë një vajzë e mbyllur në vetvete dhe nuk kisha shumë shoqëri. Im shoq ishte njeriu i parë që më bëri të ndihesha mirë. Ashtu, siç e thashë, më pëlqeu që në takimin e parë dhe i thashë familjes se isha dakord që ta lidhja jetën me të. Edhe F. (burri im) kishte shprehur pëlqimin e tij. Kështu, filluam të takoheshim gjithmonë e më shpesh derisa brenda muajit bëmë edhe fejesën.

E LUMTUR PO, POR JO SI NË FILMA

Nuk mund të them se ditën e fejesës isha aq e lumtur, siç ndodh në filma, por

as nuk mund të them se isha e trishtuar. Ishte një fejesë e thjeshtë dhe unë ndihesha mirë. Nuk dyshova për asnjë çast se po merrja një vendim të gabuar. E dija shumë mirë se në rrethinën time nuk kisha për të pasur rast më të mirë. Iu gëzova faktit se do të shkoja të jetoja në qytet me një njeri që më pëlqente. Brenda tre muajve bëmë dasmën. Nuk kaloi shumë dhe u bëmë me djalë. Im shoq mezi e priti këtë moment. E kishte fiksim të kishim një djalë dhe kjo dëshirë e madhe iu realizua. Marrëdhëniet tona ishin të mira. Ishim një çift i qetë dhe nuk ndodhte të grindeshim me njëri-tjetrin. Madje, kur na ngelte hatri apo mërzi-teshim me njëri-tjetrin, preferonim të mos flisnim fare...

Burri im kishte një shok të ngushtë që jetonte prej shumë vitesh në Zvicër. Madje, kishin jetuar disa vjet edhe bashkë në Zvicër. Burri gjithmonë më fliste për të ose, më saktë, në çdo histori që më

tregonte përmendje edhe emri i tij. Në njëfarë mënyre isha bërë kurioze ta njihja atë njeri. Më thoshte se e kishte si vëlla e shkuar vëllait...

THUAJSE KISHTE VITE QË MË NJIHTE...

Një ditë im burrë më tha se kishte ardhur Emini, shoku i tij, me të shoqen e dy fëmijët. Një ditë e kishte ftuar në darkë në shtëpinë tonë, që të njihesha edhe unë me të, meqë që kur isha martuar nuk kisha pasur rastin ta takoja. Ai erdhi me familjen e vet kah ora 8 e mbrëmjes. Unë kisha përgatitur darkë të mirë. Që kur e pashë më la përshtypje të mirë, ndoshta ngaqë ishte shumë i pashëm. Ishte burrë i gjatë e me trup të formuar. E shoqja më dukej sikur ishte disa vjet më e vjetër se ai. Fëmijët i kishte si pëllumba. Akoma më shumë më pëlqeu Emini gjatë bisedës. Vetëm bënte shaka e qeshte



me tim shoq. Ishte shumë i komunikueshëm dhe nisi t'më trajtonte menjëherë sikur kishte vite që më njihje. Edhe e shoqja ishte grua e afrueshme, andaj edhe e kaluam shumë mirë atë darkë në shtëpinë tonë.

Kur shkuan bisedova gjatë me tim burrë për ta. Ramë dakord se ishin njerëz të këndshëm...

FILLOI T'MË PËLQENTE SHOKU I BURRIT

Ata do të qëndronin në qytetin tonë, pra në Gjilan, tri javë. Takoheshim përditë me ta dhe organizonim aktivitete të ndryshme, që të kënaqeshin edhe ata, edhe fëmijët. Me kalimin e kohës u afrova shumë me Eminin. Më pëlqente të bisedoja me të. Më dukej sikur më kuptonte edhe për disa gjëra që im burrë nuk më kishte kuptuar ndonjëherë. E shoqja i fliste gjithmonë me

ëmbëlsi dhe e lavdëronte. Dukej që ishte njeri shumë i përkushtuar. Edhe unë shkoja mirë me burrin tim, por kisha edhe gjëra që nuk më pëlqenin dhe nuk e lavdëroja në sy të tjerëve.

Gjithsesi, dua të them se Emini më pëlqente gjithmonë e më shumë. E gjeja veten duke u përpjekur të rrija vetëm me të, vetëm e vetëm që të bisedoja. Më pëlqente të flisja me të. Fillova të mendoja vetëm për të. Mezi prisja ta takoja. Nuk e kuptoja se ç'ishte kjo që po më ndodhte. Nga ana tjetër, burrit tim i vinte mirë që unë kisha zënë shumë miqësi me shokun e tij të ngushtë dhe as që i shkonte në mendje se kjo mund të ishte diçka e rrezikshme. Sa më shumë kaloja kohë me Eminin, aq më shumë i vija re të metat e tim burri. Nuk e di se si ndodhte, por shpesh e gjeja veten duke e kritikuar tim shoq, sepse nuk ishte si Emini... Ai nuk xhelozonte, por më

thoshte se nuk mund të ishin të gjithë njerëzit njësoj.

FILLOVA TA XHELOZOJA GRUAN E EMINIT...

Më vjen turp ta pranoj, por fillova të ndieja xhelozë për gruan e Eminit, që ishte aq me fat dhe kishte një burrë si ai. Mendoja se ajo nuk ishte aq e mirë sa Emini dhe përsëri kishte pasur fat që kishte gjetur një burrë të përkryer. Fillova të dëshiroja që të isha në vendin e saj, edhe pse më vinte turp nga kjo dëshirë e pakontrolluar.

Ato tri javë kaluan shpejt dhe Emini me të shoqen do të ktheheshin në Zvicër. U bëmë shokë edhe në "Facebook", që të shkëmbejm fotografite që bëmë gjatë qëndrimit të tyre në qytetin tonë, pra në Gjilan. Emini e përdorte më shumë se e shoqja "Facebookun", prandaj edhe unë nisa të komunikoj me të. Ia nisja atij fotografite dhe ndonjëherë i dërgoja edhe ndonjë mesazh, ku e pyesja se si ishte ai dhe familja e tij. Ai tregoi gjithmonë shumë i sjellshëm në përgjigjet që më jepte. Unë mezi prisja të lexoja se çfarë më kishte shkruar dhe me mendjen time thurja lloj-lloj ëndrrash.

BURRI IM FARE NUK DYSHON NË MUA...

Nuk e di se si nisi një lloj komunikimi disi i rrezikshëm. Në pamje të parë nuk kishte asgjë të keqe, por herë pas herë flisnim me kujta. Këto ishin momentet më të këndshme të ditës sime. Nuk guxoja as unë dhe as ai t'i thoshim gjërat troç, por ama ia lejuam vetes që të flirtonim në një mënyrë të kamufluar. U bënë disa kohë që flas rregullisht me të. I tregoj edhe tim shoqi, me qëllim që të mos bie në sy. I them se përshëndetemi dhe pyesim për familjet e njëri-tjetrit. Tim shoqi as që i shkon mendja te ndonjë gjë e keqe.

Me pak fjalë, kam filluar të ndiej shumë për shokun e ngushtë të tim shoqi. Më duket se për herë të parë në jetë po provoj se çfarë është dashuria. Por, nuk dua as t'më paragjykon, sepse nuk dua as të prish familjen time dhe as familjen e tij, por vetëm se vetes nuk mund t'ia fsheh këtë ndjenjë. Megjithatë, shumë dilema kam brenda vetes. Kam frikë se mos ai merr guximin të shkojë më larg sesa ato biseda në internet...

D.H.



MARIGONA HILL

+383 49 162 000

+383 48 162 000

info@marigonahill.com



Dajti madhështor sikur vështronte me lakmi nga distanca kalanë e bukur të Petreles. Rrëzë tij ndjehesha i vetmuar, i tretur e pa dashuri, sepse kishte kohë t'më mungonte dashuria. Që të arrija dashurinë e saj, kapërceva fusha e male, por kur iu afrova më iku e u fortifikua brenda kalasë, për të mos u dorëzuar, e për t'më sfiduar në përpjekjet e mia pushtuese. Ajo natë e gjatë e disfatës sime më dha shtytje e fuqi që të luftoj për dashuri, madje edhe detin do e shteroja për ta fituar zemrën e saj.



DETIN

DO TA SHTEROJA

PËR TY

Atë mbrëmje të bukur ecja bregut të lumit nëpër ëndrrën time, për të arritur te ti rrugës zik-zake, jo aq të lehtë e jo të pamundimshme. Të kërkova nëpër terrin e natës gjithkrah, brigjeve të lumit e labirinthëve pranë tij, madje edhe nëpër pallatet me shigjeta, për të vazhduar kërkimin deri te stacioni i parafundit. Të gjeta atje ku më prisje, te vendi i ahengut, në afërsi të qiellit, ku engjëjt kishin fronin e tyre. Atje të gjeta ashtu siç ishe gjithmonë: e bukur, engjëllore dhe e qetë. Ishe më e qetë se edhe vetë deti Jon kur është i patrazuar, madje edhe më madhështore e më e bukur sesa bjeshka e Sharrit, e shtathollë si lumi i Lanës. Në sytë tu të përgjumur tretej nata e turbullt, ndërsa në zemrën tënde gjallëronte shpirtmadhësia.

REFUZOVE JOSHJEN TIME...

Ishe më e bukur se Deti i jugut me guralecët e bardhë. Pra, e bardhë ashtu siç është vetë zemra jote. Dhe, ajo zemër e madhe kësaj radhe nuk ishte ashtu siç e njihja, ishte më ndryshe seç ishte më parë, ishte më e egër, më e ngurtë e më e ftohtë sa as prania ime nuk e zbuti e nuk e joshi. Ashtu e ngurtë më linte përshtypjen se ngjasonte në shtratin e ftohtë e të betonuar të Lanës, që gjarpëron mes vezullimës së dritave, pa u ndalur për t'u dorëzuar. Dhe, refuzove joshjen time, jo se më urreje apo se nuk më dëshiroje, por sepse aty u gjenda në moment jo të duhur, në një kohë të papërshtatshme, kur shpirtin e kishë të trazuar e të mbushur stres dhe kur kishë humbur qetësinë shpirtërore. Ndoshta mu për këtë refuzove ftesën që ta bëra për vallëzim me mua rreth yjeve të qiellit. Por, me gjithë refuzimin që ia bëre zemrës time, ti prapëseprapë për mua mbete hyjneshe e bukur, më e bukur se yjet e qiellit, më e kthjelltë se deti i kristaltë...

Zhënjimim e natës që më sfidoi e shndërrova në urti e mirëkuptim për ty. Prandaj, i pa neveritur nga refuzimi, në qetësi të putha në mesin e ballit, e i pajtuar me disfatën të urova pa fjalë të shumta natën e mirë. Ti, si në kllapitje, kishë rënduar qepallat sikur ato të ishin rënduar nga zbrazja e gotës me verë. Nuk dija se a të shqetësonte zhënjimimi im që shprehej duke u betuar se nuk

do të propozoja edhe një herë tjetër dashuri, sepse ti nuk lëshove pe më tepër se kaq, por ma ktheve shpinën, duke më lënë të shoqëruar vetëm me terrin e natës. Shëmnia e territ m'i mori edhe ato pak ëndrra që i kisha për ty. Ashtu i etur për dashurinë tënde, u mundova të humbja mes ëndrrave që do t'më qonin atje ku dëgjohet gjëma e detit në brigjet e Jonit të bukur, të cilin i ngjason. Fatkeqësisht, atje nuk arrita dot as në ditën e re, sepse ëndrrës time i kishte zënë rrugën mohimi yt që më bëje, duke refuzuar të jesh me mua shtegtare e së nesërme. Me mirëkuptimin e plotë për ngurrimin tënd, isha ngrysur bashkë me natën e gjatë për ta takuar së paku hijen tënde në ëndrrat e mia. Mirëpo, sikur ishte tretur fryma jote, meqë nuk të gjeta as të nesërmen, ani pse të kërkova qysh pas agut të mëngjesit, edhe mes drunjve e pishave të gjata në rrugën zik-zake kah shtegtoja i vetmuar gjatë ecjes mëngjesore...

SYTË TU TË BUKUR SI ULLINJ BERATI

Nata e zymtë kishte ikur ngadalë për t'i lëshuar vendin ditës së re, ditës së shpresës që ushqeja për ty. Por, edhe shpresat shteruan atëherë kur kuptova se ti ende kllapiteshe me dergjën e natës që kishte ikur. E ndjeja se doja të të jepja shumë nga vetja ime, e për kompensim të merrja nga ti të gjitha të ligat tua, bregat dhe hallet, stresin dhe dergjen që të kishte vënë në kllapi. Të thirra që të dilja përballë e të përmbushja premtimin e dhënë, me shpresë se ishe kthjelluar, por ti nuk iu përgjigje thirrjes sime. Ti as m'u përgjigje e as nuk më ftove të m'i dorëzosh hallet, dertet e shqetësimin tënd. Heshte për të lënë përshtypjen sikur po të dhimb-seshin të m'i jepje e se parapëlqejte të vazhdoje amullinë në kllapinë e vjetër. As për këtë e as për mospërfilljen tënde nuk u egërsova e as u hidhërova, madje as për puthjen që nuk ma kishë dhuruar. Përkundrazi, kujtova sytë e tu të bukur si ullinj Berati, ata sy ngjyrrë kafeje që kaherë më kishin magjepsur, kujtova edhe zemrën tënde të bardhë që më kishte robëruar, kujtova sharmin glamuroz dhe virtytet tua që më dhanë forcë të luftoj për ty, të luftoj - sepse të dua, për çka Dajtin do ta rrafshoja e Jonin do ta shteroja.

Petrit Kalaja

YOUR SUMMER HAS AN ADDRESS

MARINA BAY - A SUMMER STATE OF MIND.

FINE DINING • ROOFTOP NIGHTS • CASINO
SPA & WELLNES • SUNSET DINING • BEACH
SEA VIEW SUITES • EXCLUSIVE EVENTS

BATOS
BY NIGHTS



MARITIM
MARINA BAY RESORT & CASINO
★★★★★

www.marinabay.al

VLORË, ALBANIA

@marinabayresort_casino

HISTORI TË PABESUESHME DIVORCI

GRUAJA NDIENTE TURP PËR TË KRYER MARRËDHËNIE SEK- SUALE

Një gjykatë në Tainan pranoi kërkesën për divorc të një burri, i cili pretendonte se e shoqja ishte aq e turpshme, saqë nuk pranonte të kryente marrëdhënie seksuale edhe pas një viti martesë. Çen, mësues 38-vjeçar, nga Tainani, ishte martuar me 29-vjeçaren Lin, gjithashtu mësuese. Sipas Çenit në natën e parë të martesës ajo fjeti e veshur me fustan dhe e mbështjellë me jorgan.

"Ti je qesharak", iu përgjigj ajo të shoqit, kur ky kërkoi kryerje të marrëdhënieve seksuale. Ajo u rikthye të nesërmen te e ëma. Lin e kundërshtoi divorcin, duke pretenduar se ajo e kishte refuzuar marrëdhënien natën e parë, sepse ndihej e lodhur, por gjykatësi tha se nuk mund të përdorte të njëjtin justifikim për një vit të tërë martesë, duke i dhënë divorcin Çenit.

BURRI PËRPIQET T'I SHOHË FYTYRËN SË SHOQES PAS 30 VJETËSH MARTESE

Më 2008 në Arabinë Saudite një grua kërkoi divorc, sepse burri i saj u përpoq t'i shihte fytyrën pas 30 vjetësh martesë. Ai kishte jetuar me të shoqen për 30 vjet me radhë pa i hedhur sytë në fytyrën e saj. Gruaja 50-vjeçare ndiqte traditën e fshatit të saj të lindjes në afërsi të Khamis Mushajt, duke mbajtur fytyrën të mbuluar gjatë gjithë kohës. Një natë i shoqi ishte bërë kurioz dhe kishte provuar t'i hiqte burkën ndërsa ajo flinte, në mënyrë që t'i shihte fytyrën, por ajo ishte zgjuar.

Pas kësaj i shoqi i kërkoi falje dhe i premtoi se nuk do ta bënte më kurrë një gjë të tillë, por ajo vendosi të kërkonte ndarjen. Mund të duket e çuditshme, por në Arabinë Saudite, çiftet të tilla të mbështjella nga misterit për njëri-tjetrin nuk janë të pazakonta.

PAPAGALLI PËRSËRISTE VAZHDIMISHT "DIVORC"


Në vitin 2001 një grua kineze filloi procedurën e divorcit pasi papagalli i familjes filloi të zbulonte pasiguritë e të shoqit. Sipas Xinmin Evening Nevs, gruaja filloi të dyshonte kur zogu filloi të përsëriste fjalë nga bisedat sekrete në telefon të të shoqit me të dashurën, gjatë mungesës së saj në shtëpi. "Divorc", "të dua", "tregohu e duruar", ishin fjalët që zogu filloi t'i përsëriste gjithë ditën në shtëpi.

Pas fillimit të procedurës së divorcit, gruaja shpresonte se mund ta merrte papagallin në gjyq si dëshmitar, por avokatët i thanë se një gjë e tillë nuk ishte e pranueshme për gjykatën kineze.

kishte takuar të dashurën 30 vjet më të re, në punë. Tradhtia u zbulua pasi ata harruan t'i mbyllnin perdet teksa ishin në një takim intim në ambientet e punës. Pas kësaj, e shoqja, Ruth, e dëboi atë nga shtëpia. Gjatë procesit të divorcit ata thanë se ishin njohur gjatë Luftës së Parë Botërore në Bon dhe kishin lindur e rritur 3 fëmijë bashkë.

GRUAJA DIVORCON BURRIN MANIAK TË PASTËRTISË

Në prill 2009 një grua gjermane divorcoi të shoqin pasi, sipas saj, ishte e "tejnogopur" me maninë e tij për të pastruar. Gruaja, e cila për 15 vjet me radhë pati mundësinë të jetonte me një burrë që lante, pastronte dhe bënte të gjitha punët e shtëpisë, e humbi durimin kur ai vendosi të shembte një faqe të murit, sepse ishte bërë pis.



BASHKËSHORTJA E KISHTE GËNJY- ER PËR MOSHËN

Një grua kineze e quajtur Luo, e cila gënjeu për moshën, u përball me kërkesën e bashkëshortit për divorc pas 10 vjetësh martesë. Ajo kishte qenë 30 vjeçe në momentin kur ishte njohur me të shoqin, por i kishte thënë atij se ishte 24. Më 2007 i shoqi kërkoi divorc pasi kuptoi se ajo kishte gënjyer.

NUK MUND TË DURONTE NGRËNIEN E DREKËS ME VJEHRËN

Më 2005 një grua rumune kërkoi divorc, sepse nuk mund të duronte faktin e të ngrënit drekë çdo ditë me vjehrrën. Gruaja 22-vjeçare kishte vetëm 10 muaj e martuar kur u ankuu se jeta e saj ishte kthyer në një makth shkaku i vjehrrës. Elena T., nga Focsani, në provincën Vrancea, i tha gjykatësit se prania e vjehrrës së saj në vaktin më të rëndësishëm të ditës, duke bërë vërejtje, po ia shkatërronte jetën.

BURRI 81-VJEÇAR KAPET NË FLAGRANCË PAS 60 VJET MARTESE

Një 83-vjeçare gjermane e divorcoi të shoqin pas 60 vjetësh martesë, sepse e kapi në flagrancë me të dashurën në ambientet e punës. Xhorxh Meister e

anaderm

A KENI PROBLEME ME VENAT VARIKOZE?

Venat varikoze janë **vena të fryra** dhe të **përdredhura** që shfaqen zakonisht në këmbë.

Ato janë rezultat i qarkullimit të dobët të gjakut dhe shpesh shkaktojnë **dhimbje, ndjesi rëndese, ënjtje, ndryshim ngjyre në lëkurë**.



Na kontaktoni!

+383 (0) 45 707 744

Infeksionet mund të shfaqen gjatë shtatzënisë, lindjes ose pas lindjes. Rrugët e infeksionit mund të janë ngjitëse, nga vagjina dhe nga tubat uterine. Rrugë të tjera të shfaqjes së infeksionit janë rrugët hematogjene – përmes gjakut ose përmes limfës – limfogjene. Ndikimi i infeksionit te foshnja varet shumë nga periudha në të cilën ndodh infeksioni (vjetërsia e shtatzënisë).

Në rastet kur infeksioni ndodh në 12 javët e para të shtatzënisë, mund të shkaktohen embriopatitë – dëmtimi i embrionit. Embriopatitë nuk janë specifike për llojin e shkaktarit të infeksionit, por janë specifike për fazën e zhvillimit – vjetërsisë së shtatzënisë kur ka ndodhur infeksioni. Nëse ndodhin dëmtime të rënda të embrionit, ndodh dështimi spontan. Këtë veprim e shfaqin të gjitha infeksionet piogjene, infeksionet me toksoplazmë ose me listerje, por edhe varicela ose klamidia. Fetopatitë, përkufizohen si dëmtim i fetusit në fazat e mëvonshme të shtatzënisë, pas javës 12 të shtatzënisë deri në lindje. Nëse infeksioni vjen në këtë periudhë të shtatzënisë, pasojat e mëvonshme varën nga lloji i shkaktarit të infeksionit.

INFEKSIONET

Infeksionet në shtatzëni kanë një domethënie specifike, duke u bazuar në faktin se bëhet fjalë jo vetëm për infeksion të nënës, por edhe të fëmijës, që mund të lërë pasoja të mëvonshme të rënda dhe të përhershme.

Shkaktarët e infeksioneve janë të njëjtët, si në rastin jashtë shtatzënisë; viruset, bakteret, protozoarët. Sa më shumë që afrohet çasti i lindjes, më të mundshme janë infeksionet bakteriale (streptokokët e grupit B), ndërsa gjatë shtatzënisë, rëndësi të veçantë kanë infeksionet virale (rubeola, varicela, citomegalovirus, parvo virus B19). Pësha, zgjatja dhe ecuria e infeksioneve varet nga numri dhe virulencia e shkaktarit, vetitë imunobiologjike, pra vetitë mbrojtëse të shtatzënisë, rrugët e përhapjes së infeksionit, si dhe vjetërsia e shtatzënisë – javët e shtatzënisë.



INFEKSIONET NË SHTATZËNI

Infeksioni i fetusit ka rrjedha të ndryshme nëse ka ardhur deri te infeksioni me toksoplazmë, varicelë ose rubeolë. Mund të shfaqen dëmtime të sistemeve të ndryshme të organizmit, ngecje intrauterine të rritjes, lindje para kohe, por mund të lindë fëmijë krejtësisht i shëndoshë, pa pasoja të mëvonshme.

KUR ËSHTË E INFEKTUAR VETËM NËNA FOSHËNJA ËSHTË PA PROBLEME

Kur bëhet fjalë për infeksion vetëm të nënës, atëherë infeksioni në shtatzëni mund të kalojë pa asnjë efekt negativ te foshnja. Pasojat e mëvonshme shfaqen në formë të leucemisë (influenza), tumore të sistemit nervor qendror (varicela), ose karcinomit


hepatocelular primar (hepatiti B). Infeksioni mund të rrezikojë jetën e të dyve. Kur është në pikëpyetje ndikimi i infeksionit në ecurinë e shtatzënisë dhe për shtatzënë mund të priten pasoja edhe më të mëdha, sidomos nëse këto infeksione janë të shoqëruara me temperaturë të lartë trupore, ose infeksionet pas lindjes në periudhën e puerperiumit, ose pas dështimit. Në këto raste, ecuria e infeksionit merr karakter shumë të rëndë, shfaqen numër i madh komplikimesh, me pasoja të rënda.

Si pasojë e infeksionit gjatë shtatzënisë shfaqen infeksionet e cipave amniale dhe plasja e parakohshme e cipave amniale, e shoqëruar me dështim spontan ose lindjen para kohe, gjë e cila shoqërohet me shkallë të lartë të vdekjes së fëmijës e nënës.

KENDA

CENTER

Trupi juaj e meriton këtë
AJENI GATI?



Rezervoni seancën tuaj të parë sot! +

DM ose na telefononi

7 rreziqet më të mëdha të martesës

Të kesh një martesë të lumtur është ëndërr e të gjithë çifteve, por mbajtja në këmbë e një marrëdhënieje ndonjëherë mund të jetë gjëja më e vështirë.



Nëse marrim parasysh faktin se numri i divorceve është shtuar shumë kohëve të fundit, atëherë duhet t'i analizojmë problemet e martesës. Sepse, në rastet kur nuk mund t'i riparojmë problemet më të vogla, ata kthehen në një pengesë që mund të shkatërrojë martesën.

1.

Mungesa e komunikimit

Në vend të zgjidhjes së problemeve duke folur, bashkëshortët preferojnë t'i lënë mbas dore ose përkundrazi të zihen. Në fund, problemet e pazgjidhura mblidhen dhe mund të sjellin fundin e martesës. Bashkëshortët duhet të mësojnë të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre pa fyer dhe ofenduar njëri-tjetrin.

2.

Mungesa e interesit

Mosvlerësimi apo mosinteresimi i duhur me familjen apo bashkëshortin/en, nga ana tjetër vlerësimi maksimal i punës, mund të zhdukë dashurinë dhe besimin.

3.

Tradhtia

Të tradhtosh bashkëshortin/en është një nga arsyet e cila mund ta shkatërrojë martesën. Krahas kësaj, është një veprim kompensimi i të cilit duket i pamundur. Për këtë arsye, besnikëria ndaj bashkëshortit/es duhet të jetë një nga principet bazë në martesën tuaj.

4.

Mosmarrëveshjet ekonomike

Edhe në martesat e lumtura mund të përjetohen probleme ekonomike. Një nga bashkëshortët mund të jetë shumë i papërgjegjshëm dhe shpenzues dhe ky fakt mund të ndikojë negativisht në martesë.

5.

Problemet mendore dhe shpirtërore

Nëse pas muajve të parë kur përdorëshin fjalët "shpirt, zemër" bashkëshorti juaj është kthyer në një person të pasjellshëm, shkak i kësaj sjelljeje mund të jenë problemet mendore dhe shpirtërore.

6.

Largësia

Kjo nuk do të thotë vetëm largim me orë të tëra nga shtëpia për arsye pune. Këtu nënkuptohet dhe largësia emocionale.

7.

Vartësia ndaj alkoolit dhe materiales

Vartësia, si problem që shfaqet si te burrat ashtu dhe te gratë, mund të fusë në krizë martesën, sepse bashkëshortët, të cilët nga paraqitja e jashtme duken si engjëj, mund të kthehen në djaj për shkak të vartësisë. Prandaj, është shumë i rëndësishëm qëndrimi larg këtyre produkteve, e nëse jeni të varur duhet të kuroheni.



CULACCINO

PRISHTINË

Shije italiane,
zemër Prishtine.

Rr. Ukshin Hoti, Prishtinë
046 150 000

Quhem Muli. Jam me arsim të lartë dhe punoj në një institucion të rëndësishëm shtetëror. Jam 42 vjeç dhe për fatin tim të keq para dy vjetësh bashkëshortja ime u nda nga jeta. I kam dy fëmijë dhe ata ndodhën jashtë vendit, meqë kanë jetuar me nënën e tyre. Duke qenë se vetmia është e vështirë, kërkova një partnere për bashkëjetesë. Por, më doli dredhtë...

Në institucionin ku unë punoj është edhe R., shefi im, të cilin e konsideroj jo vetëm epror, por edhe mikun tim më të ngushtë. Me të ndaja të gjitha problemet e punës dhe jashtë saj, të gjitha shqetësimet që kisha. Një ditë, në bisedë e sipër, i tregova se kisha vendosur që të rikrijoja familje me një partnere që di të vlerësojë familjen dhe aty për aty ai më propozoi një mikeshë të tij, e cila ishte e divorcuar. Më tha se ishte femër e mirë, familjare, pa preokupime dhe ia vlente për bashkëshorte.

ZHGËNJIMI I PAPRITUR

Një ditë, në prani të shefit tim, u takova me Lenën (kështu quhej ajo), nga Peja. Në atë takim zonja m'u duk e komunikueshme, e singertë dhe familjare. Dhe, pas disa takimeve, unë krijova bindjen se gjeta personin e dëshiruar. Filluam të takoheshim një herë në javë, meqë ajo duhej të vinte nga Peja në Prishtinë dhe për të ishte paksa larg. Dhe, kështu ndodhi deri më 7 mars, kur Lena më tha se festën e 8 Marsit do ta bënte me shoqe në një nga lokalet e qytetit të Pejës. Më 8 mars, si çdo ditë, shkova në punë dhe kah ora 11 shefi më tha që të nisesh me shërbim në Pejë, madje ma dha në dispozicion edhe veturën e institucionit. Kah ora 12, bashkë me shoferin, u nisa për në Pejë. Kah ora 16 kryem punë dhe u nisëm në drejtim të Prishtinës. Meqë ishim pa drekë, shoferi më rekomandoi të drekonim në një nga restorantet rrugës për në Prishtinë. Kur u ndalëm në një parking, për çudi, pashë të parkuar veturën e shefit tim. E kërkova në ambientet e lokalit me sy, por syri nuk ma



"SHEFI DESHI T'MA JEPTTE GRUA TË DASHURËN E TIJ!"

zuri gjëkund. Bëra porosinë me shoferin dhe pas një gjysmë ore pashë të zbriste nga shkallët e motelit shefi im. Dhe, për çudi, nja një minutë pas tij, zbriti shkallëve të motelit edhe Lena... Kur u futën në lokal ngelën të ngrirë para meje dhe shoferit. Të nesërmen shkova në zyrë dhe i paraqita shefit dorëheqjen time.

HUMBA BESIMIN NË SHEFIN TIM

Tani kam filluar punë në një institucion tjetër, por i vvarë shpirtërisht dhe me mosbesim ndaj të gjithëve, duke krijuar bindjen se shefi më paska mbajtur afër për ta bërë unë bashkëshorte të dashurën e tij.

D.H.

BUKURIA JUAJ



Të bukura në çdo kohë

Kremi që e përdoret kundër hemorroideve është i mirë për shërimin e qeskave të syve. Pasta për dhëmbë brenda natës largon njollat, mustarda është regjenerues i përsosur për flokët, përderisa specat pikantë shpejtojnë rritjen e flokut.

NJOLLAT

Pasta për dhëmbë mundet ta thajë lëkurën, prandaj në këtë mënyrë shëron aknet dhe njollat në fytyrë. Pastën lëreni të ndikojë gjatë gjithë natës në fytyrë. Mbani mend se pasta duhet të jetë e bardhë, pa kurrfarë xheli.

TË ËNJTURIT

Tanina nga çaji i zi mund të ndihmojë në shërimin apo zbutjen e të ënjturave dhe skuqjeve që shfaqen si pasojë e diellit. Pos çajit të zi, edhe çaji i gjelbër ndihmon te të ënjturit që pason nga kafshimi i insekteve.

CELULITI

Në luftën kundër lëvores së portokallit, në trupin tuaj në vaskën plot me ujë shtoni kafënë e bluar. Dihet fare mirë se kafeina nxit qarkullimin e gjakut, si dhe ndihmon në largimin e celulitit.

QESKAT NË SY

Kremi kundër hemorroideve me gjenerata të tëra përcillet te ata që kanë këtë problem dhe, me të vërtetë, ka efekt pozitiv. Kremi përmban përbërës kundër infeksioneve dhe kur ta vendosni nën sy qeskat do të zhduken.

THONJTË

Për thonj të fortë dhe lëkurë të butë rreth thonjve, së paku, njëherë brenda javës zhytini duart në vaj ulliri.

RRËNJË TË FORTA TË FLOKUT

Specat pikantë me shekuj janë pjesë e preparateve për kozmetikë. Pa marrë parasysh nëse i konsumoni apo vendosni në rrënjën e flokut, specat pikant nxitin qarkullim të rregullt të gjakut në rrënjën e flokut.


FLOKË ME SHKËLQIM

Mustarda rigjeneron flokun e dëmtuar, por nëse nuk dëshironi që floku të ketë aromën e mustardës, atëherë përdorni një maskë me ndikim të thellë.



ELEVATE YOUR EVENT

COURTYARD[®]
BY MARRIOTT



*Host your next event in our Mayoon Conference Room.
Experience elegance and attention to every detail in the heart of Prishtina.*

Book your event today.



**ITALIAN PASTA
& RISOTTO
NIGHT**

17:00

Friday

ITALIAN CLASSICS PREPARED LIVE, PAIRED
WITH EXPRESSIVE WINES AND ELEGANT
DIGESTIFS, WITH LIVE PARMIGIANO REGGIANO
WHEEL STATION.



ESTERIA
RESTAURANT

Kuzhina

"Kosovares"

MUSAKË ME PATATE

Përbërësit:

- * 1/2 kg. mish i bluar,
- * 2 qepë,
- * 2 dcl vaj ulliri,
- * 1/2 tubë majdanoz,
- * 1 kg. patate,
- * 3 vezë
- * 2 dcl qumësht,
- * kripë,
- * piper.

Udhëzim:

- Qepa pastrohet dhe pritet imët.
- Fërgohet në yndyrë derisa të zverdhët.
- Hidhet specall dhe mishi i bluar.
- Fërgohet pak, shtohen majdanozi i grirë hollë, kripa piperi.
- Ndërkohë qërohen, lahen dhe priten patatet në rrrathë.
- Gjysma e patateve shtrohen në tepsi të lyer me yndyrë.
- Derdhet yçi i përgatitur dhe rrafshohet.
- Mbi yç radhiten patatet e mbetura, shtohet 1/4 l supë ose ujë dhe tava futet në furrë të nxehtë me temperaturë 250 gradë C për t'u pjekur derisa të shteret lëngu.
- Vezët tunden, shtohet qumështi dhe masa derdhet mbi patate të skuqura.
- Hidhet pak vegetë dhe prapë kthehet në furrë të nxehtë me temperaturë 200 gradë për t'u pjekur edhe 10 min.
- Patatet mund të përgatiten edhe pa vezë, në këtë rast hidhet më tepër supë ose qumësht.



Kiflet me forma të ndryshme

Përbërësit:

- * 2 qeska tharm buke,
- * 1/2 l qumësht,
- * 2-4 lugë sheqer,
- * pak kripë,
- * 2 vezë,
- * 1 filxhan kafeje vaj,
- * 1 sheqer vanilje,
- * afro 800 gr miell,
- * 1 vezë për lyerje,
- * susam,
- * 50 gr gjalpë.

Përgatitja:

Maja ulet në pak qumësht të vakët me 1 lugë të vogël sheqer dhe 1 lugë miell. Në qumështin e vakët shtohen tharmi i ardhur, vezët, vaji, kripa, sheqeri, sheqeri vanilje dhe mielli i situr. Brumi përzihet dhe pak tundet me lugë druri e pastaj derdhet në tavolinë të përmillur dhe ngjishet mirë e mirë derisa të gatuhet një brumë i butë dhe i lëmuar. Brumi i butë vendoset në enë ku është zënë, lyhet me vaj për të mos krijuar kore, mbulohet për të ardhur dhe dyfishuar volumin për afro 2 orë në vend të ngrohtë. Brumi i ardhur ngjishet pak, ndahet në afro 20 toptha. Hapen kuleçtë në madhësi pjate dhe me ose pa djathë a xhem brenda, mbështillen kiflet në forma të ndryshme. Kiflet vijnë 30-40 minuta, kyçet furra në 190 gradë C, pastaj lyhen me vezë të tundur, u hidhet mbi susam, nga një copëz gjalpë dhe futen në furrë për t'u pjekur derisa të fryhen e të marrin ngjyrë të kuqrrmetë. Mbulothen me pecetë për 10 minuta që të zbuten, pastaj shërbehen.



DASHI

(21 Mars – 20 Prill)



Gjatë këtij muaji do e keni të vështirë të ruani një klimë të qetë për jetën tuaj në çift. Ndonjëherë do të tregoheni shumë kokëfortë dhe nuk do të toleroni për asgjë. Në disa momente të tjera do të tregoheni emotiv më shumë sesa duhet dhe kjo do e mërzhitë partnerin. Beqarëve do u kujtohet një histori e shkuar dhe do e kenë të vështirë të fiksohen pas dikujt tjetër. Shëndeti do jetë goxha i mirë.

DEMI

(21 Prill – 20 Maj)



Ky muaj do të jetë ideal për të reflektuar dhe për të marrë vendime të rëndësishme. Me partnerin do të tregoheni mjaft bashkëpunues dhe tolerantë, ndërsa ai do të mundohet herë pas herë t'u përgatisë surpriza të këndshme. Ata që kanë pasur mosmarrëveshje duhet t'i sqarojnë ato me qetësi. Beqarët do të kenë mundësi të shumta për dashuriçka, por të jenë të qetë e jo shumë entuziastë. Shëndeti do të jetë i mirë.

BINJAKËT

(21 Maj – 21 Qershor)



Ka rrezik që gjatë këtij muaji të mbizotërojë tensioni në jetën tuaj në çift. Nuk do bini aspak në një mendim me atë që keni në krah dhe kjo do të sjellë probleme. Beqarët do të kenë disa takime të rëndësishme sidomos javën e dytë të muajit. Njihini mirë personat që do të takoni që të mos pendoheni më pas. Mundohuni të hiqni edhe turpin dhe të flisni hapur me të për gjithçka. Shëndeti do të jetë i mirë.

GAFORRJA

(22 Qershor – 22 Korrik)



Komunikimi në çift do të jetë shumë i mirë gjatë këtij muaji. Do të kujdeseni më tepër për raste që keni në krah dhe do ia plotësoni të gjitha nevojat. Edhe ai nga ana e tij do të mundohet t'ua bëjë qejfin me çdo mënyrë. Beqarët nuk duhet të përqudrohen vetëm te pamja e jashtme e personave që do të takojnë, sepse kjo do i shtynte të gabonin. Shëndeti do jetë i mirë, por me pak ftohje.

LUANI

(23 Korrik – 19 Gusht)



Do të ndiheni shumë mirë pranë atij që dashuron gjatë këtij muaji dhe nuk do të tundoheni aspak nga ftesat që do u bëhen për takime. Ndjenjat për partnerin janë të forta dhe askush nuk mund t'i ftohë. Beqarët duhet të tregohen sa më realistë dhe të mos mendojnë se dashuria është një ëndërr apo se gjithçka shkon si në telenovela. Shëndeti duhet pasur më shumë në vëmendje.

VIRGJËRESHA

(23 Gusht – 22 Shtator)



Mos e fajësoni veten nëse gjërat nuk do të shkojnë mirë në çift, por mundohuni të flisni singërisht dhe sa më hapur me atë që keni në krah. Vetëm kështu do të ruani një klimë sa më të qetë. Beqarët do të ndihen mirë me miqtë e tyre dhe nuk do të kenë shumë nevojë për të kërkuar një të dashur. Shëndeti në pjesën më të madhe të muajit nuk do të jetë i mirë.

PESHORJA

(23 Shtator – 23 Tetor)



Ky muaj pritet të jetë edhe më i këndshëm për të dashëruarit. Nuk do ta keni vështirë të merrni atë që dëshironi në çdo fushë dhe kjo do ua rritë vetëbesimin. Marrëdhënia në çift do të jetë e bukur dhe bashkëpunimi do të mbizotërojë gjithë kohës. Beqarët ka gjasa të dashurohen me tërë fuqinë që kanë. Sektori i shëndetit nuk pritet të jetë problematik, megjithatë nuk duhet ta teproni me ushqim e as me dietë.

AKREPI

(24 Tetor – 22 Nëntor)



Do i shprehni më tepër ndjenjat gjatë këtij muaji dhe të do tregoheni më të kuptueshëm me atë që keni në krah. Në javën e dytë dhe të tretë priten momente të mrekullueshme, mbase edhe ndonjë vendim i rëndësishëm. Beqarët do të tregohen më të hapur ndaj takimeve dhe do të jenë gati të bëjnë sakrifica vetëm e vetëm që të kenë dikë në krah. Shëndeti do të jetë më i paqëndrueshëm se më parë.

SHIGJETARI

(23 Nëntor – 21 Dhjetor)



Me afrimin e ditëve të ngrohta do të ndiheni edhe më mirë. Ata që janë në lidhje do e dëgjojnë më shumë tjetrin dhe do i marrin parasysht opinionet e tij. Pritet që gjatë gjithë muajit të mbizotërojë ekuilibri dhe të shumëfishohen momentet intime. Për beqarët periudha do të jetë e favorshme për takime mbresëlënëse. Shfrytëzoni mundësitë që do u jepen. Shëndeti do të ketë pak probleme.

BRICJAPI

(22 Dhjetor – 20 Janar)



Komunikimi në çift do të jetë edhe më i ngrohtë gjatë këtij muaji. Zemra do u rrahë më fort dhe do të jenë të gatshëm të bëni sakrifica për të qëndruar sa më shumë kohë me atë që dashuron. Beqarët do të bëjnë atë që duhet bërë për të takuar persona interesantë. Qëndroni gjithë kohës të hapur, por mos nxitoni të merrni vendime. Problemet me gjumë mund të sjellin shqetësimë.

UJORI

(21 Janar – 19 Shkurt)



Jeta sentimentale do të ketë shumë ndryshime gjatë këtij muaji si për çiftet ashtu edhe për beqarët. Ata që janë prej kohësh në lidhje do të kenë fillimisht disa mosmarrëveshje të vogla, por pasi t'i zgjidhin do marrin vendime të rëndësishme mbi të ardhmen. Qetësia dhe kujdesi është një nga virtytet që keni. Beqarëve nuk do u mungojnë mundësitë për angazhime. Shëndeti do të jetë i shkëlqyer.

PESHQIT



(20 Shkurt – 20 Mars)



Fillimi i muajit do të jetë paksa stresues për ju. Në jetën në çift do të keni debate të ashpër me partnerin dhe shpesh nuk do të bini në një mendim me të. Mos u tregoni kokëfortë, por lëreni tjetrin të shprehet lirisht. Beqarët do të tregohen më pak të hapur dhe nuk do arrijnë të kenë lidhjen që ata kanë menduar. As shëndeti nuk do të jetë aq i mirë.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



@dentfix ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC